



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 3 / 17 janar 2017), dhe nenin 4, paragrafi 3, dhe në zbatim të nenit 59 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38 / 24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2025, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT OPERACIONAL TË SIGURUESVE**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprim**

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të përcaktoj parimet bazë për identifikimin, matjen, kontrollin dhe menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesve, strukturën dhe komponentët e tij, si dhe kërkesat mbikëqyrëse nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK).
2. Kjo Rregullore aplikohet për siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm (në vijim: siguruesit), të licencuar nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit 05/L-045 për Sigurimet (në vijim: Ligji për Sigurimet) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
  - 1.1. **Rrezik Operacional** – nënkupton rrezikun e humbjes që rrjedhë nga proceset e brendshme të dështuara ose jo të përshtatshme, dështimi i personelit ose sistemit, si dhe rreziqet e humbjeve që rrjedhin nga ngjarjet e jashtme;
  - 1.2. **Funksion** – nënkupton njësitë organizative brenda strukturës organizative të siguruesve.

### **Neni 3**

#### **Sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional**

1. Siguruesit, duhet të krijojnë një sistem të menaxhimit të rrezikut operacional, adekuat me natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të tyre, me qëllim që të identifikoj, vlerësoj, monitoroj dhe kontrolloj/zvogëloj rrezikun operacional.
2. Sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional duhet të përmbajë së paku elementet si në vijim:

- 2.1. Përgjegjësinë dhe kontrollin nga ana e Bordit të Drejtorëve;
- 2.2. Përgjegjësinë dhe kontrollin nga Komiteti për Menaxhimin e Rrezikut;
- 2.3. Rolin dhe përgjegjësitë e Menaxhmentit të Lartë;
- 2.4. Strukturë organizative të përshtatshme që përcakton qartë autoritetin dhe përgjegjësitë e secilit brenda strukturës së siguruesve; dhe
- 2.5. Politikat, procedurat dhe metodat për menaxhimin e rrezikut operacional.

#### **Neni 4**

#### **Mbikëqyrja dhe kontrollimi**

1. Bordi i Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë të siguruesve duhet ta trajtojnë rrezikun operacional si rrezik të madh dhe ata duhet të pranojnë përgjegjësinë përfundimtare për monitorimin e efikasitetit të menaxhimit të rrezikut operacional brenda siguruesve.
2. Bordi i Drejtorëve të siguruesve është përgjegjës për krijimin, miratimin dhe rishikimin vjetor të politikave të rrezikut operacional. Bordi i Drejtorëve duhet të mbikëqyrë Menaxhmentin e Lartë për të siguruar zbatimin adekuat të politikave, proceseve dhe sistemeve, në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Për këtë qëllim Bordi i drejtorëve është përgjegjës:
  - 2.1. për themelimin e strukturës organizative të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional;
  - 2.2. për zhvillimin e strategjive dhe politikave të përgjithshme për menaxhimin e rrezikut operacional, në pajtim me qëllimet strategjike të siguruesit;
  - 2.3. për rishikimin dhe miratimin e funksioneve të Menaxhmentit të Lartë, lidhur me përgjegjësitë dhe raportimin sa i përket menaxhimit të rrezikut operacional, me qëllim që të sigurohet efikasiteti i vendimmarrjes të siguruesi;
  - 2.4. për rishikimin e rregullit të raporteve mbi rrezikun operacional, të dorëzuara nga ana e menaxhmentit të lartë si dhe monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të efikasitetit të menaxhimit të rrezikut operacional;
  - 2.5. të sigurohet se menaxhmenti i lartë po ndërmerr masat e nevojshme në identifikimin, vlerësimin dhe zvogëlimin e rrezikut operacional;
  - 2.6. të sigurohet se sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional të siguruesi, auditohet në mënyrë efektive nga ana e auditimit të brendshëm të siguruesit; dhe
  - 2.7. të sigurojë sistem të përshtatshëm të shpërblimit dhe ndëshkimit për Menaxhmentin e Lartë dhe punonjësit e siguruesit, në mënyrë që të promovohet zhvillimi i një sistemi adekuat të menaxhimit të rrezikut operacional.
3. Menaxhmenti i lartë i siguruesve është përgjegjës për zbatimin e strategjive të menaxhimit të rrezikut operacional, politikave të përgjithshme dhe funksionimin e sistemeve të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të siguruesve. Për këtë qëllim, Menaxhmenti i Lartë është përgjegjës:
  - 3.1. për raportimin e rregullt të Bordit i Drejtorëve në lidhje me menaxhimin e vazhdueshëm të rrezikut operacional;

- 3.2. për hartimin dhe rishikimin e rregullt të politikave dhe procedurave për menaxhimin e rrezikut operacional, në pajtim me strategjitë dhe politikat e përgjithshme të zhvilluara nga ana e Bordit, mbikëqyrjen e implementimit të tyre, dhe paraqitjen e raporteve mbi menaxhimin e rrezikut operacional në baza të rregullta, Bordit të Drejtorëve;
  - 3.3. të kuptojë mjaftueshëm menaxhimin e rrezikut operacional të siguresit;
  - 3.4. të përcaktojë qartë përgjegjësitë e secilit funksion në menaxhimin e rrezikut operacional, përfshirë përcaktimin e linjave raportuese, shpeshtësinë dhe përmbajtjen e raporteve, të nxitë secilën njësi (funksion) të siguresit që të përcaktojë përgjegjësitë e veta, në mënyrë që të sigurohet performancë të shëndoshë të sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional.
  - 3.5. të bëjë kontrole dhe rishikime në sistemin e menaxhimit të rrezikut operacional me qëllim që në mënyrë efektive t'i përgjigjet ngjarjeve të rrezikut operacional që pasojnë nga ndryshimet e brendshme në: procedura, produkte, aktivitete biznesore, sisteme të teknologjisë informative, personel, ngjarjeve të jashtme apo faktorëve të tjerë.
4. Funkzioni për menaxhimin e rrezikut brenda siguresve është përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut operacional. Përgjegjësitë e këtij funksioni lidhur me menaxhimin e rrezikut operacional përfshijnë:
    - 4.1. hartimin e politikave, procedurave dhe proceseve të veçanta të menaxhimit të rrezikut operacional dhe dorëzimi i tyre të Menaxhmentit i Lartë dhe Bordi i Drejtorëve, për rishikim dhe miratim;
    - 4.2. ndihmon funksionet tjera të siguresit në identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe zvogëlimin e rrezikut operacional;
    - 4.3. krijimin e metodave me qëllim të identifikimit, vlerësimit, zvogëlimit (përfshirë edhe kontrollet e brendshme) dhe monitorimit të rrezikut operacional, formulimin e procesit të raportimit brenda siguresit sa i përket rrezikut operacional, organizimit dhe zbatimi të tij;
    - 4.4. vendosjen e kritereve bazë mbi rrezikun operacional brenda siguresit, si dhe udhëzon dhe koordinon menaxhimin e rrezikut operacional;
    - 4.5. organizimin e trajnime për secilin funksion të siguresit në lidhje me menaxhimin e rrezikut operacional, si dhe iu ndihmon atyre të përmirësojnë kapacitetet për menaxhimin e rrezikut operacional dhe përmbushjes së detyrave të tyre;
    - 4.6. kontrollimin dhe analizimin e praktikave të menaxhimit të rrezikut operacional në funksionet tjera të siguresit;
    - 4.7. dërgimin e raporteve mbi rrezikun operacional te Menaxhmenti i Lartë dhe Bordi i Drejtorëve;
    - 4.8. sigurimin se sistemet për matjet e menaxhimit të rrezikut operacional janë vëzhguar.
  5. Funksionet relevante të siguresit duhet të jenë përgjegjëse të drejtpërdrejta brenda përgjegjësive të veta, për menaxhimin e rrezikut operacional. Përgjegjësitë kryesore sipas këtij paragrafi përfshijnë:
    - 5.1. emërimin e stafit të caktuar i ngarkuar me menaxhimin e rrezikut operacional, duke përfshirë vëzhgimin e politikave, procedurave dhe proceseve të posaçme për menaxhimin e rrezikut operacional;

- 5.2. përcjelljen e metodave të vlerësimit për menaxhimin e rrezikut operacional me qëllim të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut operacional, dhe të ketë një procedurë të vazhdueshme efikase të monitorimit, kontrollimit/zvogëlimit dhe të raportojë rreziqet operationale, e më pas të organizoj zbatimin e tyre;
- 5.3. të marr në konsideratë kërkesat e menaxhimit të rrezikut operacional dhe kontrolleve të brendshme, veçanërisht kur krijohen procese të veçanta biznesore të njësisë perkatese organizative. Të sigurojë se personeli i menaxhimit të rrezikut operacional brenda funksionit (njësisë organizative) merr pjesë në rishikimin e procedurave, kontrolleve dhe politikave të rëndësishme në mënyrë që ti harmonizojë me politikat e përgjithshme të siguruesit për menaxhimin e rrezikut operacional; dhe
- 5.4. të monitorojë treguesit më të rëndësishëm të rreziqeve dhe rregullisht të raportojë për gjendjen në menaxhimin e rrezikut operacional të funksionit së tyre organizativ, te funksioni tjetër organizativ që ka rol udhëheqës në menaxhimin e rrezikut operacional të siguruesit në tërësi.
6. Njësia ligjore, njësia e pajtueshmërisë, njësia e teknologjisë informative, si dhe njësia e resurseve humane të siguruesit, duhet që përveç menaxhimit adekuat të rrezikut të vet operacional, të ofrojnë asistencë brenda mundësive të tyre dhe përgjegjësive respektive, njësive tjera, me qëllim të menaxhimit të rrezikut operacional.
7. Njësia e auditimit të brendshëm të siguruesit edhe pse nuk është përgjegjës i drejtpërdrejtë dhe nuk merr pjesë në menaxhimin e rrezikut operacional, duhet që rregullisht të kontrollojë dhe vlerësojë se si po operon sistemi i menaxhimit të rrezikut operacional, të mbikëqyrë implementimin e politikave të menaxhimit të rrezikut operacional. Në mënyrë të pavarur duhet t'i vlerësojë politikat, procedurat dhe proceset e menaxhimit të rrezikut operacional të siguruesit dhe i raporton Bordit të Drejtorëve rezultatet e këtij vlerësimi.
8. Siguruesi duhet të zgjedhë qasjen më të përshtatshme me qëllim të menaxhimit të rrezikut operacional. Kjo qasje duhet të përfshijë: vlerësimin e rrezikut operacional dhe kontrolleve të brendshme, raportimin e ngjarjeve të cilat kanë rezultuar me humbje dhe mbledhjen e të dhënave, monitorimin e treguesve kryesorë të rrezikut, vlerësimin e rrezikut për produktet e reja dhe praktikatat afariste, testimin dhe auditimin e kontrolleve të brendshme dhe raportimin e rrezikut operacional.
9. Siguruesi duhet të zhvillojë një proces efektiv që rregullisht të monitorojë dhe raportojë statusin e rrezikut operacional dhe humbjet materiale. Për rreziqet me potencial për rritje të humbjeve, duhet të krijohet një sistem i lajmërimit të hershëm të rrezikut operacional me qëllim të kontrollojë zvogëlimin e rrezikut dhe zvogëlimin e ngjarjeve të ndryshme që mund të rezultojnë me humbje.
10. Siguruesi duhet të krijojë dhe vazhdimisht ta përmirësojë sistemin informativ për menaxhimin e rrezikut operacional, me qëllim që në mënyrë efikase të identifikojë, kontrollojë dhe raportojë rreziqet operationale. Ky sistem, së paku duhet, të regjistrojë dhe ruaj datat e ngjarjeve dhe humbjet nga rreziku operacional. Sistemi duhet të bazohet në vetëvlerësimin e rrezikut operacional dhe masat e kontrollit, monitorimin e indikatorëve kyç të rrezikut dhe krijimin e informatave relevante të përfshira në një raport të rrezikut operacional.

## Neni 5

### Llojet e ngjarjeve që mund të rezultojnë me humbje

1. Llojet e ngjarjeve të rrezikut operacional që mund të rezultojnë me humbje, janë:
  - 1.1. Mashtrimi e brendshëm – përfshin humbjet si shkak i veprimeve të llojeve të paramenduara të mashtrimit, përvetësimit të pasurisë apo shmangies së rregulloreve, ligjit apo politikave të siguruesit, e cila përfshinë të paktën një palë të brendshme (punonjës, menaxherë të lartë të siguruesit) siç janë: raportime të gabuara dhe me dashje në lidhje me pozicionin financiar të siguruesit, kryerje e transaksioneve të paautorizuara të siguruesit, transaksione të brendshme të paautorizuara në llogarinë e punonjësit ose anëtareve të organeve qeverisëse të siguruesit, shkatërrim i qëllimshëm i pasurive të siguruesit, vjedhje, grabitje, zhvatje, përvetësime të pasurisë së siguruesit, falsifikime, evazion fiskal i qëllimshëm, fitimi pa baze i punonjësve dhe anëtareve të organeve drejtuese të siguruesit.
  - 1.2. Mashtrimi i jashtëm – përfshinë humbjet si shkak i veprimeve të llojeve të paramenduara të mashtrimit, përvetësimit të pasurisë apo shmangies së ligjit nga palët e treta jashtë siguruesit, siç janë: vjedhjet dhe grabitjet, falsifikimet, dëmtimet e qëllimshme të sistemeve kompjuterike, vjedhjet e informacionit.
  - 1.3. Praktikat e punësimit dhe siguria në punë – përfshinë humbjet e shkaktuara nga veprimet e papajtueshme me ligjet e punës, shëndetit dhe sigurisë në punë apo marrëveshjet tjera nga marrëdhënia e punës, si dhe pretendimet /kërkesat për pagesat e lëndimeve personale dhe /ose diskriminimi në punë.
  - 1.4. Klientët, produktet dhe praktikat afariste –përfshinë humbjet e shkaktuara nga dështimi për të përmbushur obligimet ndaj klientit humbjet që rrjedhin nga natyra ose projektimi i produktit, siç janë: shkeljet e detyrave të besuara (në mirëbesim), keqpërdorimi i informacionit konfidencial të klientit, pastrimi i parave, të metat (defektet) e produkteve, tejkalim i të drejtave të qasjes në programin kompjuterik të siguruesit, gabime njerëzore ose të llogaritjeve automatike.
  - 1.5. Dëmtimi fizik i pasurive- përfshinë humbjet e shkaktuara nga dëmtimi i fizik i pasurive që rrjedhin nga fatkeqësitë natyrore apo ngjarje tjera si vandalizmi, terrorizmi etj.
  - 1.6. Ndërprerja e afarizmit dhe rëniet e sistemit- përfshinë humbjet e shkaktuara nga ndërprerja e afarizmit apo rëniet e sistemeve siç janë: dështimi i plotë ose të pjesshëm të pajisjeve ose programeve, probleme të telekomunikacionit, ndërprerje të shërbimeve, vjetërsim i pajisjeve etj.
  - 1.7. Ekzekutimi, shpërndarja dhe menaxhimi i proceseve- përfshinë ngjarjet e rrezikut që lidhen me përpunimin e transaksioneve ose me menaxhimin proceseve dhe të marrëdhënieve me palë të treta siç janë: mangësi në komunikim, gabime në mbledhjen e të dhënave (shembull: të dhëna të gabuara), mosrespektimi i afateve, keqfunksionim i sistemeve, gabimet në kontabilitet, gabime në raportim, mangësi në dokumentacionin ligjor etj.

## Neni 6

### Rreziqet nga proceset, sistemet, personeli dhe rreziqet e jashtme

1. Rreziku nga proceset – përfshinë mundësinë e humbjeve si pasojë e procesimit të pakujdesshëm nga personeli, gabimeve apo aktiviteteve të paautorizuara. Siguruesit, duhet të punojnë në rritjen

e nivelit të zhvillimit të menaxhimit të rrezikut të proceseve brenda tij, duke u siguruar që secili funksion ndjekë hulumtime të rregullta vetjake të rrezikut të proceseve, minimizimi i humbjeve në rast të gabimeve gjatë procesimeve, pakujdesisë apo aktiviteteve të paautorizuara të personelit duke hartuar plane kontingjente.

2. Rreziku nga sistemet – përfshinë mundësinë e humbjeve si pasojë e dështimeve, keqpërdorimeve apo shfrytëzimit të paautorizuar të sistemeve kompjuterike. Sistemet e qëndrueshme kompjuterike duhet të jenë faktor esencial për zbatimin efektiv të strategjisë së menaxhimit të rrezikut operacional nga pikëpamja e avancimeve dhe zhvillimeve të Teknologjisë Informative. Për qëllime të këtij paragrafi siguresi duhet të:

2.1. ketë plane kontingjente me qëllim të minimizimit të humbjeve, në rast të dështimit (rënies) së sistemit;

2.2. ndërmarr masa të ndryshme me qëllim të parandalimit të prishjes së sistemit, duke përfshirë dyfishimin e sistemeve dhe infrastrukturave të ndryshme, mirëmbajtje konstante të sistemeve për të siguruar vazhdueshmëri të operacioneve si dhe krijimin e sistemit për parandalimin e fatkeqësive;

2.3. ruaj besueshmërinë e informatave të klientëve dhe parandaloj daljen e informatave. Informatat e ndjeshme duhet të jenë të koduara, hyrjet e paautorizuara nga jashtë të jenë të bllokuara dhe të ndërmerren gjitha masat e mundshme me qëllim të sigurimit të të dhënave;

2.4. ketë plan të trajnimeve dhe të mbajë sesione të trajnimeve, për të siguruar përgatitje të plotë të personelit, për rastet emergjente. Për të mirëmbajtur sigurinë, masat duhet të rishikohen bazuar në zhvillimet më të reja teknologjike.

3. Rreziku nga personeli – është pjesë përbërëse e vlerësimit të rrezikut operacional. Siguresi duhet të vlerësojë se deri në çfarë mase personeli i tij mund të ndikojë në rrezikun e ekzekutimit të operacioneve afariste me strukturën ekzistuese. Kjo përfshinë madhësinë e siguresit, kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e produkteve të tij dhe kompleksitetin e sistemeve të cilat i përdorë për kryerjen e aktiviteteve. Për qëllime të këtij paragrafi siguresi duhet të:

3.1. përcaktojë strukturën organizative në atë mënyrë që linjat e raportimit të njësive organizative të jenë të qarta;

3.2. përcaktojë përgjegjësitë e funksioneve (njësive organizative) dhe përkrahjet e vendeve të punës. Përgjegjësitë e udhëheqësve të funksioneve (njësive organizative) si dhe kualifikimet e tyre si dhe personelit duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë;

3.3. konsiderojë rrezikun e vetvetishëm (natyral) i cili përfshinë: shkallen e lëvizjes së stafit, shkallën e vendeve të lira të punës (konkurset), ndryshimet organizative si dhe madhësinë e stafit në raport me volumin e aktiviteteve;

3.4. konsiderojë rrezikun residual i cili përfshinë: abuzimin me sistemin, abuzimin me informata të besueshme, konkurset për vende të lira të punës dhe kohëzgjatja e vendeve të lira të punës deri sa të plotësohen, shkallën e mashtrimeve të brendshme, shpenzimet për kërkesat e rreme etj;

3.5. konsiderojë që rekrutimi i stafit të ri të bëhet me kompetencat e kërkuara, të jetë i vëmendshëm me trajnimet, të pajisë stafin me njohuritë e nevojshme për të kryer detyrat në mënyrë efektive dhe të bëjë një program të lëvizjes së stafit, me qëllim të shtimit të motivimit në punë.

4. Rreziqet e jashtme – përfshijnë rreziqet që rrjedhin nga krimet (vjedhjet) nga brenda/jashtë (mashtrimet, vjedhjet, plaçkitjet), katastrofat natyrore, terrori/lufta dhe rreziku politik. Ky lloj i rrezikut përfshinë edhe rrezikun ligjor, i cili është rreziku i humbjeve pasi që një kontratë nuk mund të zbatohet ligjërisht, dhe gjithashtu përfshinë edhe rrezikun që vjen si pasojë e dokumentacionit të pamjaftueshëm dhe autoritetit të pamjaftueshëm ndaj palës tjetër.

## **Neni 7**

### **Raportimet e rrezikut operacional**

1. Siguruesi në baza vjetore duhet të raportojë në BQK mbi politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut operacional dhe raportet në lidhje me rrezikun operacional.
2. Siguruesi, menjëherë, duhet të raportojë në BQK rreth ngjarjeve të rrezikut operacional, nëse ndodhin ndonjë nga ngjarjet në vijim:
  - 2.1. krime financiare, në të cilat janë vjedhur shuma të parave nga llogaria e siguruesit, në rast të vjedhjes së pasurive tjera të siguruesit, mashtrime financiare ose raste tjera që paraqesin humbje për siguruesin;
  - 2.2. ngjarje të cilat rezultojnë në dëm serioz ose humbje të të dhënave të rëndësishme të siguruesit, librave të tij, ndërprerje të operacioneve për 1 (një) dite ose me tepër, në një ose me shumë dege të siguruesit.
  - 2.3. informatat ekskluzive të siguruesit janë vjedhur, shitur apo publikuar pa lejen e tij apo ndonjë informacion i humbur i cili mund ta dëmtoj stabilitetin financiar të siguruesit;
  - 2.4. shkelje e shpeshtë e rregullave të aplikueshme nga menaxhmenti i lartë;
  - 2.5. aksidente apo katastrofa natyrore, të shkaktuara nga çfarëdo fuqie, e cila rezulton në humbje ekonomike për siguruesin. Nga ky nënparagraf përjashtohen raportimet për dëmet që rrjedhin nga veprimtaria sigurimeve (dëmet e ndodhura, dëmet e raportuara, dëmet e paguara);
  - 2.6. rreziqe tjera operationale, që mund të rezultojnë në humbjen e më shumë se 10 mijë EUR; dhe
  - 2.7. ngjarje tjera materiale, siç mund të kërkohen nga BQK-ja rast pas rasti.
3. BQK-ja rregullisht kontrollon dhe vlerëson politikat, procedurat dhe praktikat e menaxhimit të rrezikut operacional të siguruesit. Kontrollimi dhe vlerësimi sipas këtij paragrafi përfshinë:
  - 3.1. efektivitetin e procedurave të menaxhimit të rrezikut operacional;
  - 3.2. aftësinë e siguruesit për të monitoruar dhe raportuar rrezikun operacional, përfshirë treguesit kryesor të rrezikut dhe të dhënat për humbjet nga rreziku operacional;
  - 3.3. aftësinë e siguruesit që në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive të merret me ngjarjet e rrezikut operacional;
  - 3.4. nëse procedurat dhe kontrollet e brendshme të siguruesit janë rishikuar dhe audituar brenda proceseve të menaxhimit të rrezikut operacional;
  - 3.5. kualiteti dhe gjithëpërfshirja e planeve për rimëkëmbjen nga katastrofat dhe planeve të vazhdimësisë së biznesit, përfshirë edhe analizën për skenarët e ndryshëm;
  - 3.6. aspekte të tjera për menaxhimin e rrezikut operacional.

## **Neni 8**

### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje është subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Sigurimet.

## **Neni 9**

### **Dispozita kalimtare**

Përshtatja e plotë nga ana e siguruesve me të gjitha kërkesat e kësaj Rregulloreje duhet të arrihet deri më 30 prill 2025.

## **Neni 10**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës